

ARDIAN-CHRISTIAN
KYÇYKU

zv. *Libri*

Copëza jete a letre
fryntëzuar nga Teatri

Librarium Haçnuz

ARDIAN-CHRISTIAN KYÇYKU

zv.Libri

- Copëza jete a letre, frymëzuar nga Teatri -

Ardian KYÇYKU (pseudonim letrar: **Ardian-Christian Kyçyku**) është lindur në Pogradec më 23 gusht 1969. Kreu studimet e larta në Universitetin Shtetëror të Tiranës, në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, dega gjuhë-letërsi. Është doktor i shkencave filologjike, doktorand në teologji pranë Universitetit Shtetëror të Bukureshtit dhe docent në shkencat humane dhe të komunikimit. Anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Rumanisë, i Shoqatës së Shkrimtarëve të Bukureshtit, i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë dhe i Central European Academy of Science and Art. Dekan i Fakultetit të Arteve dhe Shkencave në Universitetin “Gheorghe Cristea” të Bukureshtit. Vepra letrare të shkruara e të botuara në gjuhën shqipe: *Në perandorinë e gurit, Mortët, Nata pas vitit zero, Përkthimi, Muza e Lojës, Lumenjtë e Saharasë, Oreksi për bukën e qiellit, Diva ose Ngrënësi i Luleve, Engjëjt e tepërt, Kristali dhe hienat, Sy, Si u pushtua Çmendustani, Home, Në vend të Përjetësisë*; në gjuhën rumune: *Viti kur u shpik mjellma, E fshehta e ëmbël e marrëzisë, Një fis i lavdishëm e që jep shpirt, Hyu Epigon, Dashuri me shikim të fundit, Trilogjia, Shtetrrethim - roman i shkruar me shumë pak thonjëza, Ish - roman me dashuri & konspiracion, Empatycon ose Libri i jetës së parakohëshme, Vend për një kukull të vetme – rrëfim për t’u filmuar / film për t’u rrëfyer*; përkthime: *Një alfabet i poezisë shqipe*, antologji, 101 poetë shqiptarë në gjuhën rumune; botime të tjera, përfshi ato didaktike-shkencore: *Koha e zëvendësve*, libër-intervistë kushtuar shpirtëritimit shqiptar, *Hyrje në semiotikë, Shenjat dhe Kështjella* (ligjërrata universitare). Në kuadrin e arsimit të lartë rumun jep lëndët: *Elemente të kulturës dhe qytetërimit ballkanik, Hyrje në semiotikë, Struktura e gjuhës së shtypit, Imagologjia dhe Fenomeni Audiovizual*. Nga viti 1998 është bashkëthemelues dhe bashkëdrejtues i Revistës *Haemus*, që botohet në Bukuresht. Themelues dhe kryeredaktor i revistës universitare *ComunIQ*. Krijime të tij janë përkthyer në gjuhët hungarisht, gjermanisht, spanjisht, anglisht, frëngjisht, italisht.

ARDIAN-CHRISTIAN KYÇYKU

zv. Libri

- Copëza jete a letre, frymëzuar nga Teatri -

Motto

“Këta janë ata që kaluan sprovën e madhe: i lanë petkat dhe i zbardhën me anë të gjakut të Qëngjit [...] Kurrë më s’do të kenë uri, kurrë më s’do të kenë etje, kurrë më s’do t’i djegë dielli e as rrezet e tij, sepse Qëngji që është në mes të fronit do të jetë Bariu i tyre, dhe ai do t’i çojë në burimet e ujrave jetëdhënëse. E Perëndia do të fshijë çdo lot nga sytë e tyre”.

“Pastaj zëri që dëgjova nga qielli foli sërish me mua dhe tha: *‘Shko e merre libërthin e hapur nga dora e ëngjëllit që qëndron mbi det e mbi tokë’*. Iu afrova ëngjëllit dhe iu luta të ma japë libërthin. Ai më tha: *‘Merre dhe hajje! Do të të dhembë barku, por në gojën tënde do të jetë i ëmbël si mjalta’*. Ia mora libërthin nga dora dhe e hëngra: në gojën time ishte i ëmbël si mjalta, por pasi e gëlltita stomaku pësoi dhimbje”.

Apokalipsi 7, 14-17 dhe 10, 8-11

ARDIAN-CHRISTIAN KYÇYKU

Zv.Libri

(Copëza jete a letre, frymëzuar nga Teatri)

LibrariumHaemus

ISBN: 978-606-8093-40-6

© **Ardian Kyçyku**

Coperta / Ballina: **Küdesign**

București, 2008

Pjesëmarrësit:

**IKUA – kështu ia kanë vënë nofkën
KOMANDANTI I PARË I KUFIRIT
KOMANDANTI I DYTË I KUFIRIT
KOMANDANTI I KUFIRIT FQINJ
USHTARI YNË 1 (bëhet IKUA I PARË)
USHTARI YNË 2 (bëhet KOMANDANTI I TRETË)
GONI – i ri që merr arratinë drejt Botës së Lirë
MIRA – e dashura e Gonit dhe jo vetëm e tij
ZANA (VANESA)
IKUA I PARË (ISH-USHTARI YNË 1)
GRUAJA E IKOS
VAJZA E IKOS
DJALI I IKOS
GAZETARJA E SË PËRDITSHMES “UJRAT SOT” DHE E TV
PLANETI
DJALI I IKOS TË PARË (IKUA I DYTË)
DEKORUESI, KAMERAMANI, TË PANJOHUR, USHTARË
USHTRISH TË NDRYSHME, FËMIJË, PESHKATARË, TË
MBYTUR, ZËRA DITE E NATE**

Ngjarjet zhvillohen rreth një gjemie të ndalur në *ujrat e askujt, ose të gjithkujt*, që rëndom emërtohen *neutrale*.

JAVA E PARË

I.

Ujra të kaltra dhe të zeza. Qielli është i ndarë më dysh: gjysma me diell, gjysma me dëborë. Dielli është i ngjitur me hënën, nata me ditën, uji me tokat.

Në skaj të horizontit duken vazhdimisht hije ushtarësh, oficerësh e varkash, si dhe dritëzat shumëngjyrëshe të disa qytezave të huaja.

Në anën e këtejme, dritëzat herë fiken, herë pipëtojnë.

Në lug të kësaj pamjeje ngrihet një Gjemi e madhe, me trajtë të çuditshme, si ndonjë kullë e pjerrët – ndoshta ngaqë është sajuar me drurë e trarë nga shtëpitë e vjetra të qytetit.

Nga shtiza e llampës së peshkimit sapo ka fluturuar këmisha e bardhë, si flamur i dështuar paqeje, e Ikos. Duken tri stiva me libra madhësish e trashësish të ndryshme.

Nuk fryn erë.

Ikua rri ndenjurazi pranë llampës së ndezur dhe shfleton një libër me kapakë ngjyrë hiri.

IKUA

Se njeriu librin e ha, kurse rrobat jo, komandant. Më dëgjon? Rrobat s'kanë vitamina. Prandaj nuk trishtohem që era ma mori këmishën. Duket sheshit: s'ka paqe mes nesh. Më dëgjon? S'para je në ujrat e tua sonte...

KOMANDANTI I PARË

Të dëgjoj, mor tradhtar, të dëgjoj. Edhe automatiku ka një javë që t'i dëgjon përçartjet.

IKUA

Dhe po humb durimin, ë? Apo...

KOMANDANTI I PARË

... apo do ta mbyllësh atë sqep, se na e bëre kokën dauille.

IKUA

Më mirë dauille, se shoshë, komandant. (*Shkul një grusht fletësh nga libri dhe ia drejton komandantit pa kthyer kokën*) Ke uri? Do ca faqe historie? Por kemi edhe prozë letrare, po s'na e mbajti stomaku historinë. Kemi poezi të realizmit socialist, novela, tregime, gjëagjëza... Kemi libra sa të hanë qentë, si i thonë... ndonëse këtu na rrethon vetëm uria e tytave dhe e peshqve...

KOMANDANTI I PARË

Ah, si do më kishe cicëruar po të të kisha pasur nja dy orë në atë zyrën time atje... në breg... përballë pistës së vallzimit! Njerëzia do të hidhnin valle me muzikë, ti – me dajakun tim... E di sa kreshnikë e kanë mallkuar ditën kur janë pjellë, në atë zyrë? Ja, sa një furrrik është, sa gjemia jote, ama ta nxjerr qumështin e katragjyshes pikë-pikë...

IKUA

Si puna e pikës kineze, ë? Më magjepse, komandant. Gati po më vjen keq që s'patëm fat të piqeshim në zyrën tënde. Vallë duhet të trishtohem tani që të solla gjer këtu e po të dridhen dhëmballët e vëna nga makthi?

KOMANDANTI I PARË

Ncuk! Vetëm t'i rrahësh mirë trutë e të marrësh një vendim, përndryshe do ta shohësh të sat ëme te muri i pushkatimit.

IKUA

Do ta pleqërojmë, komandant, atë punë, mos ki merak. As uri mos ki, se ka Ikua libra për ty sa të ushqehet mbarë ushtria e popullit ushtar.

USHTARI 1

T'ia shpoj kokën, komandant? Thuaj vetëm *zjarr* dhe shpëtojmë nga ai zgjeb.

KOMANDANTI I PARË

Ti kujton se unë s'di të qëlloj, mor tuhaf? Po ka lidhur në kyç të dorës atë spangon, e shikon?, dhe në fund të asaj spangos rri në pritë një qivur plot me llokume dinamiti... Merr vesh? Ta pret mendja ku e mbajmë frymën po dolën ato llokumet nga qivuri?

USHTARI 2

Atëhere t'ia këpusim spangon.

KOMANDANTI I PARË

Me se?

USHTARI 2

Me plumba.

KOMANDANTI I PARË

Hm, e drejtë... S'mund të mburresh kurrë se je fatkeq, po s'pate nën urdhër ca humbamento... Këta kujtojnë se buka bëhet në furrë. Po të kish qënë budalla, do të tretej nën dhë tani. (*Ushtarit 1*) Mban veshur një këmishë të mbushur me llokume, djalosh. E ka qepur duke u frymëzuar nga vezmet... Prandaj nuk e vrasim dot. Por as gjallë s'kemi të drejtë ta lemë... (*Ushtarit 2, me zë të ulët*) Bëj haber të na